



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE

Nr. 847 / Prot.
1

Tiranë, më 11 . 11 .2025

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 77 / datë 11 / 11 / 2025
1

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMEVE
2025–2027

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 9695, datë 19.03.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të:

- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030”,
- Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM nr. 736, datë 13.12.2023, dhe në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI), të miratuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin,

me qëllim forcimin e integritetit institucional, parandalimin e korrupsionit, rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrës publike,

URDHËROJ:

1. Të miratohet “Plani i Integritetit për Komitetin Shqiptar të Birësimeve 2025–2027”, një kopje e të cilit i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Koordinatorin për Integritetin, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të institucionit, për zbatimin, monitorimin dhe raportimin periodik (çdo gjashtë muaj) të masave të përcaktuara në Planin e Integritetit, sipas formateve dhe afateve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.
3. Të gjithë punonjësit e institucionit të njihen me përmbajtjen e planit dhe të zbatojnë detyrimet që rrjedhin prej tij, në përputhje me Kodin e Etikës dhe legjislacionin në fuqi për administratën publike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ALMA LACI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE

PLAN INTEGRITETI

2025-2027

Miraturar me Urdhrin e Brendshëm nr.77/1, datë 11.11.2025 të Kryetarit të Komitetit Shqiptar të
Birësimeve

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Komitetin Shqiptar të Birësimeve

Kryetar: Marcela Kocaj, Specialist Buxhet-Financë)

Anëtarë: Imelda Tola, Specialist (Punonjës social)

Anxhela Bakalli, Specialist (Jurist)

Ky Plan i Integritetit mbështetet në parimet dhe detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor dhe strategjik kombëtar kundër korrupsionit, duke u ndërtuar mbi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, të miratuar me VKM nr. 859/2024, dhe Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM nr. 736/2023. Ai respekton gjithashtu ligjet bazë që garantojnë etikën, transparencën dhe përgjegjshmërinë në administratën publike, përfshirë ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, ligjin “Për të drejtën e informimit”, ligjin “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe ligjin “Për nëpunësin civil”. Zbatimi i tij udhëhiqet nga udhëzimet dhe standardet e përcaktuara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, me qëllim forcimin e integritetit institucional dhe parandalimin e çdo forme abuzimi apo korrupsioni në ushtrimin e detyrës publike.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	4
LISTA E SHKURTESAVE	5
HYRJE	6
PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT	6
QASJA METODOLOGJIKE	8
OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2025-2027	8
RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT	9
MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT	12
PLANI I VEPRIMIT, 2025-2027	13

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja efektive me korrupsionin për Komitetin Shqiptar të Birësimeve është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka përgjegjësinë kryesore për realizimin me sukses të proceseve të birësimit brenda dhe jashtë vendit të fëmijëve të mitur të deklaruar të braktisur. Duke patur një rol qendror në këtë fushë, jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shembullin për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Komitetit Shqiptar të Birësimeve dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit për qytetarët.

Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e publikut tek ne.

Nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Planit të Integritetit, institucioni ynë synon të krijojë një mjedis pune që garanton integritetin institucional, si dhe të të gjithë punonjësve të institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e publikut vendas dhe të huaj në shërbimet që institucioni ynë ofron.

KRYETAR

Alma Laci

LISTA E SHKURTESAVE

MD – Ministria e Drejtësisë

MVRI – Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

KSHB – Komiteti Shqiptar i Birësimeve

PT – Programi i Transparencës

HYRJE

Plani i Integritetit 2025–2027 i Komitetit Shqiptar të Birësimeve (KSHB) është hartuar në përputhje me kuadrin e ri strategjik dhe ligjor të qeverisë shqiptare për forcimin e integritetit institucional dhe parandalimin e korrupsionit, të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, miratuar me VKM nr. 859, datë 26.12.2024, si dhe në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM nr. 736, datë 13.12.2023. Ky plan përfaqëson angazhimin institucional të KSHB për të garantuar ushtrimin e funksioneve publike në përputhje me parimet e ligjshmërisë, etikës, transparencës dhe llogaridhënies, në mbrojtje të interesit publik dhe të drejtave të qytetarëve. Procesi i hartimit është zhvilluar në mënyrë gjithëpërfshirëse, përmes vlerësimit të riskut të korrupsionit në aktivitetet e institucionit, analizës së procedurave administrative dhe përfshirjes së punonjësve në identifikimin e masave parandaluese. Plani synon të forcojë kulturën e integritetit, të rrisë ndërgjegjësimin e stafit mbi etikën profesionale dhe të sigurojë një mjedis pune të ndershëm e transparent, në përputhje me vizionin qeveritar “Parandalim – Ndëshkim – Ndërgjegjësim”, si dhe me objektivat e qeverisjes së mirë dhe besueshmërisë publike që përfaqëson KSHB.

PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Komitetin Shqiptar të Birësimeve konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1. Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit

Me urdhrin e brendshëm nr.77, datë 11.11.2025, është ngritur grupi i punës për vlerësimin e riskut të integritetit për hartimin e Planit të Integritetit në përputhje me VKM nr. 859, datë 26.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030”, procesi i hartimit të planeve të integritetit Në përbërje të grupit të punës kanë qenë specialistë të KSHB-së, të cilët kanë realizuar procesin e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit, si dhe hartimin e Planit të Integritetit.

2. Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, grupi i punës analizoi kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kuadrin e brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të KSHB-së. Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat e mbledhura nga anketimi i stafit të institucionit mbi çështje të integritetit dhe etikës në institucion si edhe

për të vlerësuar njohuritë e tyre mbi kuadrin rregullator dhe struktural për integritetin në institucion.

3. Vlerësimi i risqeve të integritetit

Në këtë fazë, grupi i punës vlerësoi risqet e analizuara në fazën e mësipërme duke u mbështetur në mundësinë e risqeve për të ndodhur dhe në ndikimin në rast të ndodhjes së riskut. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit kontribuuan të dhënat e mbledhura nga pyetësorët, si dhe intervistat me stafin e institucionit.

4. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshin masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për periudhën 2025-2027. Kostot financiare të këtij Plani do të mbulohen nga buxheti i Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

5. Përmbajtja e Planit të Integritetit

Përmbajtja e Planit të Integritetit paraqitet si më poshtë:

- **Deklarata e Integritetit Institucional** – shprehja e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional nga ana e titullarit të KSHB-së;
- **Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të KSHB-së**, përshkrimi i fazave të procesit të planifikimit të integritetit dhe qasja metodologjike;
- **Risqet e integritetit dhe faktorët e tyre** – i cili përfshin një përshkrim të risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre në fushat e përgjegjësisë së institucionit.
- **Plani i Veprimit**, i cili përmban masat e kontrollit që duhet të ndërmerren për të adresuar risqet e identifikuar dhe të vlerësuara.

QASJA METODOLOGJIKE

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në Komitetin Shqiptar të Birësimeve, në përputhje me MVRI, u përdorën dy metoda:

1. Metoda cilësore

- Përmes zhvillimit të intervistave dhe diskutimeve me stafin e institucionit, ku morën pjesë të gjithë punonjësit e institucionit (në total 8 punonjës);
- Përmes analizës së kuadrit rregullator të brendshëm të institucionit (rregullore të brendshme, procedura pune, plane pune etj).

2. Metoda sasiore

- Përmes vlerësimit me anë të një pyetëso, në të cilin punonjësit e KSHB iu përgjigjën pyetjeve mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Në anketim morën pjesë të gjithë punonjësit e institucionit, të cilët plotësuan pyetësoin në mënyrë anonime.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2025-2027

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Planit Integriteti, Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka vendosur tre objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2025-2027, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara. Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë 2025-2027, të Planit të Integritetit janë:

1. Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit;
2. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
3. Sigurimi i nivelit më të lartë të transparencës me publikun.

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmblëdhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në KSHB. Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit, rezultoi si në vijim:

1. Fusha e menaxhimit financiar

Pasi u verifikua dokumentacioni financiar, rezultoi se zyra e financës çdo fillim viti harton një plan pune për të gjitha aktivitetet që lidhen me fushën e financës dhe buxhetit, për realizimin e të cilit raporton rregullisht. Po ashtu, sipas udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë hartohet brenda afateve Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA). Të gjitha shpenzimet e institucionit përballohen me fonde nga Buxheti i Shtetit. Fondet buxhetore të miratuara sipas artikujve kontabël janë të mjaftueshme për realizimin e veprimtarisë së KSHB-së dhe në asnjë rast nuk janë krijuar detyrime të prapambetura. Zbatimi i buxhetit vjetor monitorohet në mënyrë progresive gjatë vitit, rakordohet me Degën e Thesarit dhe raportohet edhe pranë MD-së. Po ashtu, edhe të ardhurat dytësore që institucioni realizon rakordohen me Degën e Thesarit nëpërmjet situacioneve mujore. Sa i takon aktiveve afatgjata dhe qarkulluese të institucionit, rezulton se kryhet inventarizimi, vlerësimi dhe procedurat e daljes nga përdorimi të tyre sipas legjislacionit në fuqi brenda afateve të përcaktuara. Mbahet dhe përditësohet vazhdimisht regjistri i aktiveve të institucionit ku reflektohen edhe shtesat dhe pakësimet e aktiveve gjatë vitit. Lidhur me fushën e prokurimeve publike, KSHB ngre çdo fillim viti Komisionin e Prokurimeve me Vlera të Vogla dhe Komisionin e Blerjeve me Vlerë nën 100.000 lekë, të cilët kryejnë procedurat e blerjeve. Për çdo proces të punës mbahen procesverbalet përkatës. Gjithashtu, KSHB harton dhe miraton çdo vit regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe regjistrin e realizimit. Në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore, rekomandohet që institucionet e varësisë të integrojnë proceset e tyre financiare në sistemet digjitale të Ministrisë së Financave (AFMIS dhe e-Prokurimi), si dhe të publikojnë në faqen zyrtare të institucionit informacion për realizimin buxhetor dhe kontratat publike për të rritur transparencën. Për të gjithë transaksionet financiare ruhet gjurma e auditit, si dhe të gjitha praktikrat dhe dokumentet ruhen dhe arkivohen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në këtë fushë nuk është evidentuar asnjë risk.

2. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore

Nga shqyrtimi i kuadrit të brendshëm rregullator të institucionit, rezulton se të gjithë punonjësit kanë plan vjetor pune dhe harta të proceseve të punës, por mungon një manual i përditësuar i procedurave të punës që reflekton ndryshimet e fundit në legjislacionin e shërbimit civil (Ligji nr.152/2013 dhe VKM nr.243/2015, të ndryshuara). Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të lartë. KSHB ka një organikë të miratuar me 9 punonjës nga të cilët 1 prej tyre janë vakante. Nga vlerësimi i situatës rezulton mungesë në staf në pozicionet e nivelit ekzekutiv. Prania e pozicioneve vakante ul efektivitetin e proceseve të punës. Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të lartë.

Një komponent shumë i rëndësishëm i zhvillimit të burimeve njerëzore është trajnimi i vazhdueshëm. Nga vlerësimi rezulton se institucioni ka miratuar një plan vjetor trajnimesh, por duhet të përfshijë temat që lidhen me integritetin, etikën publike, menaxhimin e konfliktit të interesit dhe përdorimin e teknologjive të reja administrative (HRMIS, e-signature, etj.), në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit. Disa nga sfidat që identifikohen janë:

- Rregullim i ulët normativ i proceseve të punës dhe paqartësi në përgjegjësitë;
- Kapacitete njerëzore dhe teknike të kufizuara në disa prej proceseve të punës.

3. Fusha e kontrollit, auditimit dhe mekanizmave kundër korrupsionit

Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka hartuar dhe miratuar një sërë dokumentesh strategjike që mbështesin integritetin institucional, përfshirë Rregulloren e Brendshme të institucionit, Rregulloren për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe Kodin e Etikës së Komitetit Shqiptar të Birësimeve, i cili është miratuar dhe aktualisht është në zbatim. Kodi i Etikës përcakton qartë parimet, vlerat dhe standardet e sjelljes që duhet të ndjekin punonjësit gjatë ushtrimit të funksioneve publike, si dhe rregullat për parandalimin e konfliktit të interesit, ruajtjen e integritetit dhe respektimin e etikës profesionale. Ky dokument shërben si udhëzues praktik për sjelljen dhe përgjegjësinë institucionale të punonjësve dhe është shpërndarë për njohje dhe zbatim nga i gjithë stafi. Publikimi i tij në faqen zyrtare të institucionit rekomandohet për të forcuar transparencën dhe aksesin e publikut në politikat e etikës.

Në vijim, rekomandohet që Kodi i Etikës dhe rregulloret ekzistuese të plotësohen me dispozita të posaçme që rregullojnë:

- deklarimin dhe administrimin e dhuratave, sponsorizimeve dhe donacioneve;
- menaxhimin e procesit të sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve sipas Ligjit nr.60/2016;
- veprimtaritë e jashtme të punonjësve dhe deklarimin e tyre;
- mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit;
- rregullat për konsultimin publik dhe komunikimin me palët e interesuara.

KSHB ka ngritur njësinë për sinjalizim, por nevojitet përditësimi i rregullave të brendshme për regjistrimin, hetimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, si dhe miratimi i një regjistri të dhuratave dhe përfitimeve të ngjashme në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Sfida kryesore që mbetet në mjedisin institucional është përditësimi dhe unifikimi i kuadrit rregullator të integritetit, në mënyrë që të përfshijë të gjitha elementet që kërkon legjislacioni i ri për etikën, sinjalizimin dhe transparencën.

4. Fusha e transparencës

Nga analiza përmbajtësore e faqes zyrtare të internetit të KSHB-së, vihet re se publikohen të dhëna dhe informacion me karakter kryesisht informues. Nuk janë të publikuara të gjitha informacionet dhe dokumentet që lidhen me mekanizmat monitorues, të kontrollit dhe llogaridhënës. *Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të lartë.*

Koordinatori për të Drejtën e Informimit është caktuar me akt të titullarit, dhe të dhënat e

tij janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Nuk konstatohen ndryshime të shpeshta të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.

Programi i Transparencës (PT) përfaqëson një instrument që kontribuon për transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucionit, një detyrim i përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e së drejtës për informim. KSHB e ka publikuar PT në faqen zyrtare të tij, por informacioni i PT nuk është i plotë dhe mungon akses i kuadrit ligjor dhe regjistrave të prokurimeve publike. *Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të lartë.*

5. Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve dhe informacionit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga KSHB, rezultoi se, modelet e dokumentave të përdorura nga stafi i institucionit janë të unifikuara. Gjithashtu, të gjithë dokumentat regjistrohen në regjistra dhe libra protokollit duke marrë datë dhe numër protokollit.

Pranë KSHB është ngritur dhe funksionon arkiva e institucionit, për menaxhimin e të cilës është përgjegjës specialisti i arkivë-protokollit. Ky specialist ka rolin kryesor në menaxhimin e fondit arkivor të institucionit.

Po ashtu, KSHB ka ngritur Komisionin e Ekspertizës, i cili analizon të gjithë dokumentacionin që përpunon institucioni. Komisioni ka hartuar listën me afatet e ruajtjes së dokumentave në KSHB, e cila është e publikuar edhe në faqen zyrtare web www.kshb.gov.al.

Gjithashtu, për sa i përket sistemeve elektronike, KSHB nuk disponon ende asnjë sistem elektronik, për ruajtjen e të gjitha të dhënave dhe dokumentacionit të institucionit.

Në përputhje me Udhëzimin nr.12, datë 20.02.2025 “Për administrimin elektronik të dokumentacionit publik dhe arkivimin digjital”, KSHB duhet të ndërmarrë hapat për kalimin drejt sistemit të menaxhimit elektronik të dokumenteve dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik për komunikimin ndërinstitutional.

Sa i takon dhënies së informacionit, në faqen web të KSHB gjendet informacioni që vihet në dispozicion pa kërkesë dhe pa pagesë. Po ashtu, të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion duke u paraqitur fizikisht pranë institucionit, duke kontaktuar në numrat e telefonit të vënë dispozicion apo duke na shkruar në rrugë shkresore apo elektronike në adresën info.kshb@kshb.gov.al. Të gjitha kontaktet e institucionit janë të publikuara në web-in e KSHB.

Dhënia e informacionit realizohet duke garantuar në çdo rast konfidencialitetin e të dhënave personale në zbatim të përcaktimeve ligjore në nenin 36 dhe 37, të Ligjit nr.9695, datë 19.03.2017 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” dhe

Udhëzimit nr.38, datë 05.08.2013 “Për veprime të Komitetit Shqiptar të Birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale”.

Në këtë fushë nuk është evidentuar asnjë risk.

MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar.

Implementimi i planit të integritetit do të monitorohet rregullisht çdo gjashtë muaj nga personi përgjegjës i caktuar nga titullari i institucionit. (Në përputhje me MVRI dhe SNKK 2024–2030, KSHB cakton Koordinatorin e Integritetit si përgjegjës kryesor për monitorimin, me mbështetje nga grupi ndër-seksional i integritetit.) Ky punonjës është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit. Raportimi i zbatimit bëhet çdo 6-mujor (06/12) me format standard, me tregues (KPI), vlerë bazë dhe objektiva vjetore

Rezultatet e monitorimit të planit të integritetit do të bëhen publike në kuadër të praktikës institucionale të transparencës. Përmirësimet dhe korrigjimet korrigjuese dokumentohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo cikli monitorimi.

PLANI I VEPRIMIT, 2025-2027

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së KSHB. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

- Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe mekanizmave të kontrollit;
- Garantimi i transparencës më të lartë të punës dhe veprimtarisë së KSHB-së brenda institucionit dhe me publikun.

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Objektivi 1: Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore								
Nr.	Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
1.1	Përditësimi i hartave të proceseve të punës dhe përcaktimi i procedurave të punës që duhet të ndiqen sipas proceseve.	Harta e proceseve të punës e rishikuar	6M I 2025	Stafi i KSHB sipas fushës së përgjegjësisë	I lartë	Gabime/shmangie të proceseve të punës	Rishikimi i manualit të proceseve të punës	Burimet njerëzore të institucionit; pa kosto shtesë financiare
1.2	Rishikim i vazhdueshëm i hartave të proceseve dhe përditësimi i aktiviteteve në mbështetje edhe të ndryshimit të legjislacionit në fuqi.	Harta e proceseve të punës e rishikuar	Periodik: 2025–2027	Stafi i KSHB sipas fushës së përgjegjësisë	I lartë	Gabime/shmangie të proceseve të punës	Rishikimi i manualit të proceseve të punës	Burimet njerëzore të institucionit; pa kosto shtesë financiare

1.3	Plotësimi i pozicioneve vakante të punës.	Strukturë organike e plotësuar	6M I 2025	Titullari dhe Punonjësi përgjegjës për burimet njerëzore në KSHB në bashkëpunim me DAP	I lartë	Mbingarkesë e stafit aktual dhe ulja e efektivitetit të punës	Deklarimi i pozicioneve vakante pranë DAP dhe ndjekja e procedurave të rekrutimit	Burimet njerëzore të institucionit; pa kosto shtesë financiare
1.4	Ndjekja e trajnimeve sipas nevojave të stafit dhe fushave të përgjegjësisë (fusha sociale dhe prokurimet publike).	Staf i kualifikuar	6M II 2025	Stafi i KSHB në bashkëpunim me ASPA	I mesëm	Ulja e standardit të punës si pasojë e mungesës së kualifikimit të stafit	Ndjekja e trajnimeve të zhvilluara nga ASPA sipas fushave përkatëse	Stafi i KSHB; pa kosto shtesë financiare
1.5	Evidentimi i vazhdueshëm i nevojave për trajnim i stafit të ri apo ekzistues.	Staf i kualifikuar	2025-2027	Stafi i KSHB në bashkëpunim me ASPA	I mesëm	Ulja e standardit të punës si pasojë e mungesës së kualifikimit të stafit	Ndjekja e trajnimeve të zhvilluara nga ASPA sipas fushave përkatëse	Stafi i KSHB; pa kosto shtesë financiare

Kuadri i brendshëm rregullator

Objektivi 2: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe mekanizmave të kontrollit								
Nr.	Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
2.1	Rishikimi i rregullores së brendshme të KSHB duke siguruar: - përfshirjen e funksioneve/njësive që rrjedhin nga ligje të tjera, si ai për të drejtën e informimit apo	Rregullore e brendshme e KSHB-së e rishikuar	6M I 2025	Titullari dhe Stafi KSHB	I lartë	Mundësi për abuzim me detyrën / pozicionin e punës; Koordinim i parregullt brenda institucionit si dhe ndërinstitutional si pasojë e rregullave jo të qarta të komunikimit;	Përgatitja e draft rregullores së brendshme të KSHB dhe dërgimi për miratim pranë Ministrisë së Drejtësisë	Stafi i KSHB; pa kosto shtesë financiare

	njoftimit dhe konsultimit publik, njësisë së sinjalizimit apo konfliktit të interesit; - përcaktimin e linjave të qarta të komunikimit dhe raportimit ndërmjet punonjësve të institucionit, si dhe të punonjësve të KSHB me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit; - komunikimin me institucionet me të cilat KSHB bashkëpunon; - parashikimin e procedurave dhe rregullave për këshillimin me publikun; - parashikimin e rregullave për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.					Gabime në dhënien e informacionit për publikun; Mos-përmbushja e parimeve të integritetit gjatë ushtrimit të detyrës apo përfaqësimit të institucionit		
2.2	Reflektimi i ndryshimit të praktikave të punës në rregulloren e brendshme të institucionit	Rregullore e brendshme e KSHB e rishikuar	2025-2027	Titullari dhe Stafi KSHB	I lartë	Mundësi për mosrespektimin e rregullave dhe procedurave të punës; Mundësi për gabime/shmangie të proceseve gjatë ofrimit të shërbimit	Përgatitja e draft rregullores së brendshme të KSHB dhe dërgimi për miratim pranë Ministrisë së Drejtësisë	Stafi i KSHB; pa kosto shtesë financiare
2.3	Publikimi i rregullores së brendshme dhe rregullores për	Rregulloret e brendshme	6M I 2025	Stafi KSHB	I lartë	Mosnjohja nga ana e stafit dhe publikut e procedurave të punës	Pasqyrimi i rregulloreve të brendshme në web-	Stafi i KSHB; pa kosto

	parandalimin e konfliktit të interesit në faqen zyrtare web të institucionit	të KSHB të publikuara				dhe rregullave që lidhen me integritetin institucional	in zyrtar të institucionit	shtesë financiare
2.4	Publikimi dhe zbatimi i Kodit të Etikës së KSHB (i miratuar); trajnime dhe monitorim i respektimit	Kodi i Etikës i publikuar; raport vjetor zbatimi	6M I 2025 & periodik	Titullari dhe Stafi KSHB	I lartë	Mundësi për mungesë të integritetit të institucionit dhe stafit të tij; Prania e rasteve të konfliktit të interesave; Mundësi për dëmtimi i imazhit / reputacionit të KSHB	Ngritja e grupit të punës për hartimin e Kodit të Etikës; Miratimi i Kodit të Etikës; Publikimi në faqen zyrtare web të KSHB	Stafi i KSHB; pa kosto shtesë financiare
2.5	Hartimi dhe publikimi i kuadrit rregullator që lidhet me parimet e integritetit në institucion, konkretisht: - Rregulla për pranimin e donacioneve / sponsorizimeve dhe funksionimin e regjistrat përkatës; - Rregulla për veprimtaritë e jashtme të punonjësve; - Rregulla për procedurën e hetimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve dhe veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni.	Rregulla dhe procedura që përcaktojnë parimet e integritetit të miratuara	6M II 2025	Titullari dhe Stafi KSHB	I lartë	Mos-përmbushja e parimeve të integritetit gjatë ushtrimit të detyrës apo përfaqësimit të institucionit	Hartimi, miratimi dhe publikimi i rregullave dhe procedurave që garantojnë integritetin	Stafi i KSHB; pa kosto shtesë financiare

Objekti 3: Garantimi i transparencës më të lartë të punës dhe veprimtarisë së KSHB brenda institucionit dhe me publikun

Nr.	Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
3.1	Përditësimi i informacionit në faqen web të KSHB; Publikimi i bazës ligjore mbi të cilën KSHB ushtron veprimtarinë e vet, duke bashkëlidhur dhe links përkatës ku mund të aksesohet legjislacioni.	Informacion i plotë dhe i aksesueshëm mbi punën dhe shërbimet e institucionit	Periodik: 2025-2027	Specialist (Jurist) pranë KSHB	I lartë	Mungesa e transparencës ndaj publikut; Mungesa e aksesit të bazës ligjore nga ana e stafit, gjë që mund të ul efektivitetin në punë.	Përgatitja e bazës ligjore në fushën e birësimeve dhe publikimi i tyre për publikun dhe çdo person të interesuar.	Stafi i KSHB; pa kosto shtesë financiare
3.2	Publikimi në web-in e institucionit të materialeve raportuese dhe llogaridhënëse ndaj publikut, konkretisht: - Regjistrat e parashikimit të prokurimeve publike; - Regjistrat e realizimit të prokurimeve publike.	Regjistrat e prokurimeve publike të publikuara për publikun	Periodik: 2025-2027	Komisioni i Prokurimeve Publike me Vlerë të Vogël dhe blerjeve me vlerë nën 100.000 lekë	I lartë	Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.	Përgatitja e regjistrave të prokurimeve publike sipas formatit të miratuar dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të institucionit.	Komisioni i Prokurimeve Publike me Vlerë të Vogël dhe blerjeve me vlerë nën 100.000 lekë; pa kosto shtesë financiare

3.3	Publikimi i raporteve 6-mujore të monitorimit të Planit të Integritetit dhe regjistrimit të kërkesave për informacion	Raporte 6M & Regjistër TI të publikuar	06/12 çdo vit	Koordinatori për Integritetin & KDI	I lartë	Mungesë llogaridhënieje	Seksion i dedikuar "Integriteti" në web; arkiv vjetor	Pa kosto
------------	---	--	---------------	-------------------------------------	---------	-------------------------	---	----------